

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

**FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE
KOMPJUTERIKE**

Departamenti: Informatikë Inxhinierike



PUNIM DIPLOME

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Artan Rexhepi

Kandidatja:

Deniza Atiq

Mitrovicë, 2021

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

**FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE
KOMPJUTERIKE**

Departamenti: Informatikë Inxhinierike



PUNIM DIPLOME

Dizajni grafik dhe minimalizmi

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Artan Rexhepi

Kandidatja:

Deniza Atiq

Mitrovicë, 2021

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij punimi është të shtjellojë termin e dizajnit grafik, atij modern dhe minimalist. Historinë e dizajnit grafik, njohjen me metodat e para të përdorura të kësaj lëmie. Njihemi me dizajnin grafik modern, qasjen dhe ndikimin e kësaj metode, identifikojmë metodat e dizajnit modern dhe me raste konkrete bëjmë analizën e dizajneve. Kuptojmë dhe analizojmë elementet universale të dizajnit si forma, ngjyra e nuancat e saj, materialet tekstuale. Qasemi dhe fillojmë të studiojmë shkrirjen e dizajnit grafik modern në atë minimalist. Me anë të kontekstit historik dhe modern identifikojmë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet stileve moderne e minimaliste. Analizojmë dizajnin minimalist duke shtjelluar të gjitha elementet që e bëjnë një dizajn të identifikohet si minimalist. Njihemi me neominimalizmin si nënkategori e re e inovative e dizajnit minimalist. Përmes analizës së këtyre termeve ofrojmë një kuptim të gjerë të rolit të minimalizmit në jetën e përditshme dhe ndikimin e grafikës kompjuterike në edukimin e brezave pasardhëse duke u ndikuar tërësisht në thjeshtimin e qasjes së kësaj metode duke e bërë më lehtë të kuptueshme e atraktive. Pas studimit të praktikave dhe duke iu përmbajtur tërësisht rasteve të studimit fillojmë me zhvillimin e një dizajni, kështu duke plotësuar të gjitha kriteret e dizajnit modern e minimalist.

Fjalët kyçe: Dizajni modern, dizajni minimalist, neominimalizmi.

Përmbajtja

ABSTRAKT.....	I
Deklarata e originalitetit / autorësisë	1
Hyrja	2
1. Historiku i dizajnit grafik.....	5
1.1.1 1890: Art Nouveau	6
1.1.2 1903: Wiener Werkstätte.....	7
1.1.3 1919: Bauhaus	8
1.1.4 1947: Paul Rand’s corporate logos.....	9
1.1.5 1970: Postmodernizmi	10
1.1.6 1990: Softuerët Dixhital	10
2. Dizajni Grafik Modern	12
2.1 Drejtimet e dizajnit grafik modern.....	12
2.2 Qëllimi i dizajnit grafik modern	13
2.3 Identifikimi i metodave të dizajnit modern.....	13
2.3.1 Paletat e ngjyrave neutrale	13
2.3.2 Format gjeometrike.....	14
2.3.3 Ilustrimet dhe ikonat e sheshta.....	14
2.3.4 Fontet klasike Serif	15
2.3.5 Sllajdet rrëshqitëse të rrjeteve sociale.....	15
2.3.6 Videot e ngarkuara me tekst.....	16
3. Shkrimja e dizajnit grafik modern në atë minimalist	16
3.1 Konteksti historik dhe modern i dizajnit grafik nga paradigma e dizajnit minimalist	17
3.2 Identifikimi i metodave të dizajnit modern dhe minimalizmit duke paraqitur kriteret baze të dizajnit grafik minimalist/modern	20
3.3 Euforia për format minimale të dizajnit grafik	20
4. Parimet themelore të minimalizmit në dizajnin grafik	20
4.1 Zotërimi i thjeshtësisë	21
4.2 Vlerësimi i neutralitetit	21
4.3 Arritja e ekuilibrit	22
4.4 Vendosja e hierarkisë	23
4.5 Përdorimi i hapësirës negative.....	23
4.6 Pse markat prestigjioze përqafuan dizajnin minimalist?	24

4.7	Kur përmbajtja mbizotëron, më pak është vërtet më shumë.....	24
5.	E ardhmja e dizajnit minimalist	25
5.1	Neo-minimalizmi	25
5.1.1	Përdorimi i kujdesshëm i fonteve kreative	25
5.1.2	Përdorimi i imazheve të rëndësishme.....	26
5.1.3	Ngjyrat dhe nuancat e thjeshta	27
5.1.4	Ekulibrimi.....	27
5.2	Aplikimi i neo minimalizmit.....	28
6.	Trendet e së ardhmes	29
6.1.1	Minimalizmi po bëhet i zakonshëm	29
6.1.2	Ngritja e dizajnit 3D.....	30
6.1.3	Zëvendësimi i blogjeve me përmbajtje vizuale	30
6.1.4	Përdorimi i tipografisë si shprehje artistike	31
6.1.5	Dizajn që ju bën ta shikoni	31
7.	Krijimi i dizajnit sipas parimeve të stilit minimalist.....	32
7.1	Procesi i dizajnit	32
7.1.1	Fotografite inspiruese	32
7.1.2	Skicimi.....	33
7.1.3	Punimi në softuer grafik.....	33
7.1.4	Shtjellimi i ideve rreth dizajnit të linjave skicore.....	35
7.1.5	Thjeshtësimi dhe balancimi i dizajnit	35
7.1.6	Neutraliteti	36
7.1.7	Finalizimi.....	36
8.	Përfundimi.....	37
9.	Literatura.....	38
	Lista e figurave	40

Deklarata e origjinalitetit / autorësisë

Ky Punim Diplome i nivelit bachelor është puna ime origjinale duke respektuar autorësinë e çdo burimi të informacioneve dhe rregullave për një punim të mirëfilltë shkencor, dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, për një gradë në këtë apo ndonjë universitet tjetër.

Sipas njohurisë time, punimi nuk përmban asnjë material të botuar ose shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit.

Gjithashtu, deklaroj se, në shkrimin e punuar kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të UMIB.

Hyrja

Dizajni grafik është profesioni dhe disiplina akademike, aktiviteti i të cilit konsiston në projektimin e komunikimeve vizuale që synojnë të transmetojnë mesazhe të veçanta tek grupet shoqërore me objektiva të veçanta. Është një degë ndërdisiplinore e dizajnit, themelet dhe objektivat e së cilës sillen rreth përcaktimit të problemeve dhe përcaktimit të objektivave për vendimmarrje, përmes krijimtarisë, inovacionit dhe të menduarit anësor së bashku me mjetet dixhitale, duke i transformuar ato për interpretim të duhur. Ky aktivitet ndihmon në optimizimin e komunikimeve grafike. Njihet gjithashtu si dizajn vizual i komunikimit.

Dizajni grafik ka fusha të ndryshme të njohurive të fokusuara në çdo sistem komunikimi vizual. Aplikohet në strategjitë e reklamimit, ose mund të aplikohet edhe në botën e aviacionit. Në këtë kuptim, në disa vende dizajni grafik lidhet vetëm me prodhimin e skicave dhe vizatimeve, por komunikimi vizual është një pjesë e vogël e një game të madhe të llojeve dhe klasave ku mund të aplikohet. Dizajni mund të ndihmojë në shitjen e një produkti ose ideje. Zbatohet për produktet dhe elementet e identitetit të kompanisë si logot, ngjyrat, paketimet dhe tekstet si pjesë e brendit.

Gazetat, revistat, blogjet, dokumentarët e televizionit dhe filmit përdorin dizajn grafik. Dizajni i informacionit mund të përfshijë vizualizimin e të dhënave, i cili përfshin përdorimin e programeve për të interpretuar dhe formuar të dhënat në një paraqitje vizualisht bindëse, dhe mund të lidhet me infografikat.

Në vijim do të fillojmë të njohim në brendësi dizajnin grafik, si parësi duke filluar nga pyetjet.

Pyetja e parë: Cilat elemente të dizajnit grafik duhet të ekzaminohen për të kuptuar marrëdhënien mes minimalizmit dhe dizajnit grafik?

Dizajni minimalist përshkruhet si dizajn bazë, i zhveshur nga elementet e panevojshme, ngjyrat, format dhe teksturat e tepërta. Qëllimi i tij është të bëjë që përmbajtja të dallohet dhe të jetë pika qendrore. Nga pikëpamja vizuale, dizajni minimalist ka për qëllim të jetë qetësues dhe të sjellë në mendje thelbin e dizajnit. Elementet e dizajnit grafik të cilat duhen ekzaminuar për të kuptuar marrëdhënien mes minimalizmit dhe dizajnit grafik janë:

1. Përmbajtja dhe veçoritë

Qëllimi është që t'i jepet përparësi të gjitha përmbajtjeve dhe veçorive, në mënyrë që ato të mund të identifikojnë se cilët janë komponentët thelbësorë të dizajnit. Tre aspektet që kjo analizë duhet të marrë parasysh janë: numri i zgjedhjeve, përmbajtja e gjeneralizuar, vendosja e përmbajtjes së nivelit të lartë.

2. Imazhet

Imazhet janë të shkëlqyera për të komunikuar ide. Kur përdoret si duhet, imazhet mund të veprojnë si pikë fokusi ose mund të përdoren për të krijuar balancë.

3. Tipografia

Zgjedhja e shkronjave është jashtëzakonisht e rëndësishme në dizajnin grafik e atë minimalist. Duhet të trajtohet me kujdes të shtuar. Dizajni i mirë përmban tipografi të pastër dhe lehtë të lexueshme. Ngjashëm me imazhet, tipografia mund të përdoret për të krijuar pika fokusi.

4. Ngjyrat dhe kontrasti

Zgjedhja e ngjyrave duhet të jetë po aq e thjeshtë, e ngjasueshme me zgjedhjen e tipografisë. Shtimi i ngjyrave dhe kontrastit i jep një botëkuptim tjetër dhe më të thellë çdo lloj dizajni.

5. Përdorimi i hapësirës së bardhë

Hapësira e bardhë, e njohur gjithashtu si hapësira negative, është hapësira boshe midis përmbajtjes. Hapësira e bardhë është një ndër përbërësit kritikë të minimalizmit, sepse ndihmon dizajnet të marrin frymë.

6. Hierarkia vizuale

Hierarkia vizuale është marrëdhënia midis elementeve vizuale. Hierarkia e mirë vizuale lëviz syrin e vizitorit nëpër faqe dhe tërheq vëmendjen te disa elemente.

Këto gjashtë elemente konsistojnë dhe ekzaminojnë lidhjen e kuptueshmërinë e dizajnit grafik dhe minimalizmit si njësi grafike.

Pyetja e dytë: Si mund të kuptohet forma, ngjyra, sinjalet tjera gjuhësore, materialet, tingulli dhe lëvizja në të shprehurit e komunikimit të dizajnit minimalist?

Duke u nisur nga parimi i përditshëm jetësor thelbi i vërtetë i një stili jetese minimalist është përcaktimi i asaj që na jep vlerën më të madhe në jetë dhe heqja e gjithçkaje që është thjesht e tepërt. Është një mënyrë shumë e qëllimshme e të jetuarit që shkakton ndryshime pozitive në pothuajse të gjitha aspektet e jetës. Të zgjedhësh një stil jetese minimaliste do të thotë të zgjedhësh ta jetosh jetën me qëllim të madh. Një mënyrë jetese minimaliste përfshin të jetuarit me më pak burime qoftë në aspektin e një shtëpie apo pronësie. Është pjesë e procesit të të menduarit se si një person zgjedh të jetojë me të gjitha gjërat minimale në jetë dhe megjithatë të jetë i kënaqur, është një mënyrë jetese radikale, por më tepër një mënyrë jetese optimale. Si në jetë reale ashtu edhe në dizajn, format minimaliste janë fuqi shprehëse e parësore të përjetimit të eksperiencave nga një pikëpamje komplet tjetër. Zgjedhja për të jetuar një jetë të lirë e jo "të ndjekësh një skenar".

1. Historiku i dizajnit grafik

Termi “dizajn grafik” së pari është paraqitur në vitin 1922 në esenë e William Addison Dwiggins e quajtur “New Kind of Printing Calls for New Design”. Si dizajner i librit, Dwiggins shpiku termin për të shpjeguar se si ai organizonte dhe menaxhonte artin në librat e tij.

Historia e dizajnit grafik na kthen edhe më mbrapa në vitin 1760 përkatësisht në epokën e Revolucionit Industrial dhe Litografisë. Revolucioni Industrial i cili frymtoi në fund të viteve 1700, solli me vete teknologji të reja për rritjen e efikasitetit dhe prodhimit të proceseve prodhuese, përfshirë dizajnimin. Siç vuri në dukje një profesor në ligjëratën e tij mbi dizajnin e sistemeve të projektimit, "Dizajni grafik është një mënyrë relativisht e re e të shprehurit, kryesisht një përgjigje ndaj nevojave të revolucionit industrial."

Litografia ishte një nga shpikjet më të mëdha të dizajnit në Revolucionin Industrial. E shpikur nga Alois Senefelder, [1] litografia është një metodë e printimit që përfshin ngjyrosjen e dizajnit në një sipërfaqe prej guri ose metali dhe transferimin e tij në një fletë letre. Kjo risi gjithashtu i dha rrugën kromolitografisë, e cila është thjesht litografi, por për printime me ngjyra. [2]




Figura 1: “Rapid Transit” nga Muzeut i Bostonit Athanaeum

1.1.1 1890: Art Nouveau

Art Nouveau ishte një lëvizje globale e dizajnit që pati ndikim në arkitekturë, modë dhe dizajnin grafik në fund të shekullit të 19 -të. Siç thuhet në faqen e internetit të Muzeut Tate, arti i ri karakterizohet nga linja sinusale dhe forma organike që bazohen në format e bimëve. Kjo formë e dizajnit shihet në një prej posterëve të artistit të famshëm Henri de Toulouse-Lautrec [3] në vitin 1893. Në këtë poster përshkruhet një performancë në Jardin de Paris.



Figura 2: Jane Avril nga Henri de Toulouse-Lautrec

Art nouveau ishte i rëndësishëm sepse inkurajoi artistët të përcjellin subjektet e tyre jo tamam siç janë, por më tepër përmes formave interpretuese të shprehjes, lëvizjes dhe përfaqësimit abstrakt.

1.1.2 1903: Wiener Werkstätte

Në lindjen e shekullit të 20-të, piktori Koloman Moser dhe arkitekti Josef Hoffmann themeluan Wiener Werkstätte, që do të thotë "punëtorja e Vjenës" tashmë e njohur si "kooperativë produktive e artizanëve" që vlerësuan mjeshtërinë me cilësi të lartë.

Në përgjigje të industrializimit në rritje, ky kolektiv i dha përparësi shprehjes individuale dhe krijimeve avangarde. Sidoqoftë, këta artista nisën një trend të dizajnit të karakterizuar nga gjeometria dhe modernizmi, dhe "stili katror", si në posterin e mëposhtëm. [4]



Figura 3: Historia e Dizajnit Grafik

Këto modele të ashpra dhe linja të mprehta paraprijnë modelet dixhitale dhe ato grafike që do të pasojnë.

1.1.3 1919: Bauhaus

Dizajni grafik modern siç e njohim sot mund të gjurmohet në shkollën Bauhaus në Gjermani. E themeluar nga Walter Gropius, stili Bauhaus nisi një mënyrë të re e të menduarit që ndërthur artet dhe zanatet, stilet klasike dhe avangarde, formën dhe funksionin. Hartimet e Bauhaus përfshinin minimalizmin, format gjeometrike dhe shkronjat e thjeshta të reja.



Figura 4: Staatliches Bauhaus në Weimar 1919-1923

Rezultati revolucionarizoi sesi njerëzit e zakonshëm e përjetonin jetën e përditshme, përmes objekteve që preknin, përdornin dhe mbështeteshin në to. Nëse keni admiruar e vlerësuar ndonjëherë elegancën e një iPhone¹, tashmë e kuptojmë në thelb ndikimin e stilit Bauhaus.

¹ iPhone është telefon i mençur nga marka Apple

1.1.4 1947: Paul Rand's corporate logos

Paul Rand ripërcaktoi reklamat kur ndihmoi disa nga korporatat më të mëdha të Amerikës të formonin identitetet e markave të tyre me anë të logove. IBM, UPS, ABC dhe American Express - të gjitha këto kompani të mëdha u transformuan nga modelet dhe dizajnet e Paul Rand. Në fakt, logoja e IBM që ai krijoi në vitet 1970 është ende në përdorim sot - duke dëshmuar se dizajni efektiv jo vetëm që tejkalon hendekun mes kompanive dhe njerëzve, por gjithashtu i reziston kohës. [5]




Figura 5: Logo nga Paul Rand për IBM

Reklamat e Randit kanë fjalë dhe fotografi, por të gjitha ato janë shkrirë në një simbol.

1.1.5 1970: Postmodernizmi

Postmodernizmi doli si një evolucion nga rebelimi kundër ideve moderniste. Nga natyra e tij, postmodernizmi nuk pajtohet me një grup të caktuar idealesh. Modelet postmoderne shpesh vinin në dyshim autoritetin, ideuan kundër ideve të themi “monotone” të kohës dhe iu afruan gjithçka që kishte ardhur më parë me skepticizëm dhe ironi.



Figura 6: Marilyn Monroe (1967) nga Andy Warhol

Në historinë e dizajnit grafik, kjo lëvizje shpesh shoqërohet me të tjera koncepte si konceptualizmi dhe arti pop. Pra, në këtë epokë, shohim Andy Warhol duke dekonstruktuar ikonat amerikane si kanaçet e supës së Campbell dhe portretet e Marilyn Monroe. [6] Po ashtu vihet re arti i Jackson Pollock i njohur për format më eksperimentale dhe ekspresioniste të pikturës.

1.1.6 1990: Softuerët Dixhital

Në fund të shekullit të 20-të, softuerët dixhital morën lapsat dhe furçat e ngjyrës nga duart tona, dhe siguruan mënyra të reja, revolucionare për krijimin dhe shpërndarjen e modeleve e dizajneve grafike. Photoshop, softuer² i cili u lançua në vitin 1990, njihet si një platformë e redaktimit grafik që çdokush mund ta përdorte për të ndërtuar modele të shkallës profesionale. [7] Shumë programe rudimentare të tjera si Microsoft Paint gjithashtu e bënë artin grafik të kompletohet.

² Softueri është një grup i komandave e udhëzimeve të cilat ekzekutojnë detyra të veçanta në kompjuter.

Edhe mënyra se si ndërveprojmë me dizajnin grafik ndryshoi. Në vitin 1984, Apple prezantoi kompjuterin Macintosh. Ai përmbante një ndërfaqe të thjeshtë dhe miqësore, lehtë të përdorshme për përdoruesit.




Figura 7: Verzioni 1990 i Adobe Photoshop nga PetaPixel




Figura 8: Kompjuteri Macintosh i prezantuar nga Steve Jobs

2. Dizajni Grafik Modern

Dizajni grafik modern mbulon gjerësisht të gjitha sferat e jetës që merren me komunikimin vizual, nga librat dhe posterat deri tek aplikacionet e sofistikuara të celularëve dhe animacionet 3D. Është një disiplinë artistike e cila nuk është asgjë pa funksionalitet. Dizajni grafik modern luan një rol të rëndësishëm në çdo aspekt vizual të tregtisë dhe kulturës njerëzore, qoftë postera dhe libra ose ndërfaqe të animuara për përdoruesit dhe aplikacione celulare. [8] Truri jonë është i programuar në atë mënyrë që shumë më shpejt ti absorbojë imazhet sesa tekstin e shkruar, pasi fotografitë mbahen mend më lehtë dhe ndërveprojnë në një nivel të nënndërgjegjshëm me trurin tonë pa bërë përpjekje për ta përpunuar atë vullnetarisht. Ngjyrat, format dhe simbolet janë elementet bazë të cilat përceptohen dhe ndërveprojnë me trurin tonë. Kjo metodë i paraqet audiencës nxitje vizuale dhe emocionale që tërheq shikuesit dhe i inkurajojnë ata të ndjekin një rrugëtim të markës (brendit). [9]

2.1 Drejtimet e dizajnit grafik modern

Në ditët e sotme, dizajni grafik është një sferë tepër e gjerë për aplikimin e shkrirjeve artistike. Në veçanti përfshihen:

- Dizajni editorial
- Ilustrimi
- Dizajni i “identitetit”(logo dhe brendi)
- Ikona dhe piktograme³
- Tipografia



Figura 9: Shembull i dizajnit editorial dhe dizajnit ilustrativ

³ Piktogrami është simbol grafik që ngjason me një objekt fizik, ndryshe njihet edhe si *picto*.

2.2 Qëllimi i dizajnit grafik modern

Qëllimi kryesor i dizajnit grafik modern është komunikimi. Vet dizajni grafik është komunikim vizual: përdor tipografi, imazhe dhe ngjyra për të përfaqësuar ide ose mesazhe të caktuara. Ai kombinon së bashku fotografinë, ilustrimin, elemente dinamike për të krijuar modele atraktive të cilat mund të tërheqin vëmendjen e shikuesve, t'i shndërrojnë ato në shitje dhe të hapin rrugë të reja biznesi. [10]

2.3 Identifikimi i metodave të dizajnit modern

Dihet se trendet identifikuese të dizajnit modern ndryshojnë nga viti në vit. Këtë vit metodat e dizajnit modern që mbizotëruan janë:

2.3.1 Paletat e ngjyrave neutrale

Ngjyrat neutrale janë ngjyra që kanë një ngopje të ulët (në krahasim me ngjyrat e gjalla). Ato japin ndjesi të sigurtë, organike, madje edhe nostalgjike.




Figura 10: Paleta e ngjyrave neutrale

2.3.2 Format gjeometrike

Nga format e lëshuara-likuide dhe abstrakte e deri tek ato të ngurta, me tehe të forta e gjeometrike, këto janë disa nga format më të përdorura për të identifikuar dizajnin modern.



Figura 11: Modele të formave të shumëllojshme gjeometrike

2.3.3 Ilustrimet dhe ikonat e sheshta

Shumë marka përdorin ikona dhe ilustrime të sheshta në grafikën e tyre të rrjeteve sociale, punimin e uebfaqeve, etj. Ikonat janë një mjet i fuqishëm për komunikimin vizual. Me një ikonë të thjeshtë, ju mund të komunikoni kuptimin në më pak hapësirë sesa me fjalë.




Figura 12: Ikonat e sheshta

2.3.4 Fontet klasike Serif

Fontet Serif janë një nga stilet më të vjetra të shkronjave në përdorim. Ato datojnë që nga shekulli i 15 -të. Për shkak të kësaj, fontet serif zakonisht shihen si klasike dhe të besueshme. Ato ngjallin një ndjenjë nostalgjie.



Figura 13: Disa lloje të fontit Serif

2.3.5 Sllajdet rrëshqitëse të rrjeteve sociale

Sllajdet rrëshqitëse janë një mënyrë vizuale e komunikimit të mesazheve më të gjata sesa një postim i vetëm. Vet algoritmi i LinkedIn duket se promovon këto sllajde rrëshqitëse shumë më tepër sesa një postim të vetëm.




Figura 14: Sllajdet rrëshqitëse

2.3.6 Videot e ngarkuara me tekst

Videot që përdorin tekstin në ekran për të komunikuar mesazhe janë një mënyrë për të përçuar mesazhe në mënyrë më të shpejtë dhe efektive. Në vend që të kenë nevojë për një ekip të tërë produksioni për të krijuar një video, brendet mund të krijojnë një video thjesht të ngarkuar me tekst në një kohë të shkurtër.




Figura 15: Video e ngarkuar me tekst

3. Shkrija e dizajnit grafik modern në atë minimalist

Modernizmi pasqyron një jetesë të thjeshtuar, poashtu krijon forma që ndjekin funksionin. Dizajni modern e ai minimalist karakterizohen me ngjashmëri e dallime të cilat bëjnë që shkrija e këtyre dy stileve të ofrojë një dizajn të pastër e të mirfilltë. [11] Në vijim do vrojtojmë disa nga dallimet diskrete të cilat i bëjnë të ve!anta këto stile:

- Modernizmi krijon forma që ndjekin funksionin - Minimalizmi krijon forma të cilave u është hequr funksioni.
- Modernizmi ofron një plan të hapur - Minimalizmi siguron një plan të hapur.
- Modernizmi ka detaje minimale - Minimalizmi eliminon detajet minimale.
- Modernizmi është kufizues - Minimalizmi tërheq kufizimet moderniste.

- Modernizmi përfaqëson epokën moderne - Minimalizmi përfaqëson minimalizmin.
- Modernizmi është i izoluar - Minimalizmi është i vetmuar. [12]

3.1 Konteksti historik dhe modern i dizajnit grafik nga paradigma e dizajnit minimalist

Minimalizmi përshkruan një stil i cili dallohet nga ashpërsia e qartësisë, mjeteve dhe formës, si dhe thjeshtësia në strukturë dhe cilësi. Është arti i shprehjes së një teme komplekse me anë të disa objekteve të thjeshta ose figurave gjeometrike dhe eliminimi i formave e elementeve që nuk janë domosdoshmërisht të nevojshme. Në histori minimalizmi njihet si një lëvizje që sundon kryesisht në vitet 1960 dhe në fillim të viteve 1970 në forma të ndryshme të artit kur artistë të tillë si Frank Stella me veprat e tij të njohura si “Pikturat e Zeza” të cilat u ekspozuan në Muzeun e Artit Modern në Nju Jork në 1959, filluan të largoheshin nga arti gjestues i gjeneratës së mëparshme dhe dizajnit si arti vizual, muzika, arkitektura, letërsia dhe shumë më tepër. I ndikuar nga epoka e modernizmit dhe thuhet se Frank Stella është homologu i ekspresionizmit abstrakt. [13]



Figura 16: “Pikturat e Zeza”(1967) nga Frank Stella

Zhvillimi i minimalizmit është i lidhur me zhvillimin e artit konceptual i cili gjithashtu lulëzoi në vitet 1960 dhe 1970. Të dy lëvizjet sfiduan strukturat ekzistuese për krijimin, përhapjen dhe shikimin e artit dhe argumentuan se rëndësia që i është dhënë objektit të artit është e gabuar dhe çon në një botë të ngurtë dhe elitë të artit, të cilën vetëm disa persona të privilegjuar mund të përballojnë ta shijojnë.

"Forma ndjek funksionin", është një nga motot më të njohura të botës së dizajnit e cila u krijua në këtë periudhë, për të shprehur besimin se dizajni gjithmonë duhet t'i japë përparësi përdorshmërisë e estetikës. Reduktimi i ngjyrave, formave deri në thjeshtësinë elementare u bë me qëllim të ruajtjes së natyrës së tyre themelore.



Figura 17: Thjeshtësia e dizajnit minimalist

Kjo do të thotë se, në thelbin e tij, dizajni minimalist ishte menduar të ishte thjesht funksional. Qëllimi ishte zbrazja e veprës së shprehjes, emocioneve dhe çdo dekorimi të panevojshëm. Besohej se një produkt dizajni ka arritur formën e tij më të mirë kur asnjë element nuk mund të hiqet (ose shtohet) për ta bërë rezultatit më të plotë dhe funksional sesa është tashmë.



Figura 18: Eliminimi i elementeve të panevojshme

Dizajni minimalist mund të identifikohet nga një kornizë që është e thjeshtë. Vetëm elementet e nevojshme për funksionalitet përfshihen në dizajn. Elementet si ngjyra dhe tipografia përdoren gjithashtu me theks në thjeshtësinë me paleta jashtëzakonisht të zbukuruara që mund të përfshijnë vetëm një nuancë ose shkrim. Detajet dhe hapësira janë faktorë të projektimit që me të vërtetë sundojnë estetikën. Për shkak se nuk ka shumë elemente për të punuar, çdo ndarje e projektimit paraqitet në ekran. [14]




Figura 19: Poster i punuar në stilin minimalist

3.2 Identifikimi i metodave te dizajnit modern dhe minimalizmit duke paraqitur kriteret baze te dizjanit grafik minimalist/modern

Dizajnerët grafikë në të gjithë botën kanë përqafuar plotësisht artin e minimalizmit dhe rezultatet kanë qenë më se inkurajuese. Që nga “start-ups” e deri tek markat prestigjioze interesimi për artin minimalist tanimë ka mbërthyer të gjitha lëmitë. Interesimi i lartë për uebfaqe të pa ngarkuara, elegante dhe ndërfaqe moderne e efektive konfirmon se trendi minimalist është me të vërtetë një metodë në rritje e sipër.

3.3 Euforia për format minimale të dizajnin grafik

Origjina e lëvizjes së minimalizmit në art dhe arkitekturë të shoqërisë perëndimore daton në mesin e shekullit të 20-të në SHBA, kur minimalizmi u krijua si revoltë kundër dominimit të ekspresionizmit abstrakt, zgjerimit alarmues të mediave masive dhe përhapjes së mentalitetit të konsumatorit.

"Forma ndjek funksionin", një nga motot më të njohura të botës së dizajnit, u krijua në këtë kohë, duke shprehur besimin se dizajni duhet gjithmonë t'i japë përparësi përdorshmërisë estetike. Reduktimi i ngjyrave, formave dhe metodave të thjeshtësisë elementare u bë me qëllim të ruajtjes së natyrës së tyre themelore. E që do të thotë se në esencë dizajni minimalist ka për qëllim të jetë thjesht funksional. Qëllimi është zbrazja e të shprehurit, emocioneve dhe çdo dekorimi të panevojshëm. Besohet se një produkt dizajni ka arritur formën e tij më të mirë kur asnjë element nuk mund të hiqet (ose shtohet) për ta bërë rezultatin më të plotë dhe funksional sesa tanimë tashmë.

4. Parimet themelore të minimalizmit në dizajnin grafik

Rregullat pas minimalizmit mund të duken të drejtpërdrejta, por lustrimi i aftësisë për të thënë shumë duke thënë pak është një proces që kërkon vite eksplorimi dhe praktike.




Figura 20: Shembull i artit minimalist

4.1 Zotërimi i thjeshtësisë

Kur bëhet fjalë për dizajnin grafik, thjeshtësia luan një rol vendimtar në drejtimin e vëmendjes së vëzhguesit dhe ndihmën e tyre për të kuptuar një produkt. Sa më pak elemente që janë në përzierje, aq më të mëdha janë shanset që të dy këto qëllime të përmbushen.




Figura 21: Arti i linjës

Një dizajn funksional duhet të jetë gjithmonë i këndshëm për t'u parë dhe i lehtë për t'u përdorur. Nëse ndonjë element grafik ndikon negativisht në lexueshmërinë ose përdorshmërinë e një produkti të dizajnuar, ai ose duhet të zëvendësohet ose hiqet.

4.2 Vlerësimi i neutralitetit

Minimalizmi përshkruan një përdorim të kufizuar të ngjyrave dhe kërkon kujdes kur bëhet fjalë për të eksploruar mundësitë brenda paletës së ngjyrave. Me një përdorim të menduar të kontrastit, projektuesit mund të aplikojnë prekje të ngjyrave të gjalla në mënyrë që të tërheqin vëmendjen tek elementet që janë të rëndësishme më të lartë.



Figura 22: Dizajni minimalist i një produkti

Dizajni grafik minimalist lejon vetëm fonte të thjeshta, të lexueshme. Dizajnet ekstravagante e të çuditshme shmangen me çdo kusht, dhe fontet kombinohen me shumë kujdes.

4.3 Arritja e ekuilibrit

Harmonia vizuale midis të gjithë elementëve grafikë është një tjetër aspekt jetësor i dizajnit minimalist. Bilanci si një objektivi i projektimit korrespondon me marrëdhënien midis formave, ngjyrave dhe hapësirave negative, të cilat duhet të shpërndahen në mënyrë të përshtatshme në të gjithë paraqitjen. Për të arritur bilancin në dizajne, dizajnerët grafikë shpesh përdorin të ashtuquajturat sisteme të rrjetave që ndihmojnë në përafrimin dhe kontrollin e pozicioneve të të gjithë elementëve të rëndësishme të dizajnit.




Figura 23: Logo e dizajnuar me anë të sistemit të rrjetave

4.4 Vendorsja e hierarkisë

Hierarkia vizuale i ndihmon dizajnerët të ndjekin gjurmët e planifikuara të elementeve, duke i lënë ata të dinë se cilat pjesë të informacionit të shikojnë të parën, të dytën, të tretën etj. Elementet e dizajnit të tilla si ngjyra, madhësia, përbërja dhe tipografia luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e hierarkisë dhe caktimin e përparësive vizuale.




Figura 24: Hierarkia vizuale

4.5 Përdorimi i hapësirës negative

Një nga elementët më intrigues të dizajnit, veçanërisht i rëndësishëm në dizajnin minimalist, është hapësira negative. Edhe pse është më së shpeshti e bardhë, mund të jetë edhe çdo ngjyrë tjetër. Minimalizmi përshkruan planifikimin për shumë hapësirë negative në dizajn, në mënyrë që të ndihmojë në balancimin dhe theksimin e elementeve të tjera të dizajnit në bazë hierarkike. [15]



Figura 25: Dy shembuj të përdorimit të hapësirës negative

4.6 Pse markat prestigjoze përfaquan dizajnin minimalist?

Marka të shumta me famë, si Apple, Chanel, HP dhe Dior, krijuan identitete vizuale që përputhen me thjeshtësinë dhe sofistikimin për të cilin qëndrojnë, duke krijuar uebfaqe të pastra dhe elegante, burime minimaliste në rrjete sociale dhe materiale të thjeshta, por me stil të sofistikuar.





Figura 26: Uebfaqe të punuara në stilin minimalist



Përfshirja në frymën minimaliste të dizajnit nuk është një vendim që marrin brendet vetëm për të qenë në modë dhe të rëndësishme. Thjeshtësia është provuar të jetë një prirje që nuk del kurrë nga moda, gjë që e bën atë tërheqëse për markat dhe konsumatorët. Modelet minimaliste të projektimit janë të përjetshme dhe rifreskohen lehtësisht kur është e nevojshme, duke përfaqësuar një bazë të fortë për qëndrueshmërinë dhe njohjen e identitetit të markës gjë që e bënë tejet afatgjate në treg.

4.7 Kur përmbajtja mbizotëron, më pak është vërtet më shumë

Dizajni minimalist nuk është vetëm i përhershëm dhe tërheqës. Ai është gjithashtu shumë i gjithanshëm dhe i zbatueshëm në një shkallë të lartë: nga paketimi dhe produktet e printuara deri tek logot dhe uebfaqet, nuk ka fushë të dizajnit grafik që nuk mund ta përdorë këtë metodë moderne. Dizajni minimalist sjell qartësi e cila ndihmon markat të shihen si progresive në tregun e konkurrencës, duke u fokusuar kështu në tendencat e dizajnit bazuar në elemente vizuale të ndritshme, të ndezura dhe pretenduese.

TIME™

Figura 27: Logo e punuar në stilin modern minimalist

5. E ardhmja e dizajnit minimalist

Një trend tjetër në rritje, kategori e minimalizmit njihet si neo-minimalizëm. [16]

5.1 Neo-minimalizmi

Neo-minimalizmi është një stil trendi i dizajnit i cili e çon minimalizmin tradicional në nivelin tjetër. Eliminon edhe më tepër detaje dhe krijon hapësirë negative gjatë përdorimit të ngjyrave tërheqëse dhe tipografisë. [17]




Figura 28: Shkrirja e artit tradicional në neo-minimalist

Arsyeja pse neo-minimalizmi po fiton popullaritet të gjerë është se njerëzit po tërhiqen drejt filozofisë më pak është më shumë. Kjo ka të bëjë me komunikimin në mënyrë efektive ndryshe prej komunikimit të gjithçkaje, poashtu cilësisë mbi sasinë. Truku është të gjendet një mënyrë më kreative për të shprehur shumë me pak.

5.1.1 Përdorimi i kujdesshëm i fonteve kreative

Meqenëse stili neo-minimalist mbështet përdorimin e sa më pak elementeve të jetë e mundur, është e rëndësishme të sigurohemi që këto elemente të jenë tërheqëse pa komprometuar lexueshmërinë. Prandaj duhet të gjejmë ekuilibrin e duhur midis krijimtarisë dhe



Figura 29: Fontet në stilin neo-minimalist

lexueshmërisë së dizajnit. Po ashtu duhet të kemi kujdes dhe të shmangim përdorimin e më shumë se dy llojeve të fonteve.

5.1.2 Përdorimi i imazheve të rëndësishme

Imazhet e rëndësishme kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në arritjen e neo-minimalizmit. Ato ndihmojnë në krijimin e pikave fokale. Zgjidhim imazhin që dëshirojmë ta përdorim duke pasur parasysh ekuilibrin, simetrinë, kontrastin dhe hapësirën e hapur. Pika fokale mund të jetë në subjektin e fotografisë, dhe na duhet që ta balancojmë modelin duke vendosur tekst të caktuar anash. Në këtë mënyrë, dizajni nuk do të duket i detyruar por delikat. Kjo gjithashtu do të ndihmojë spektatorin që së pari të ndiejë atë që bën duke parë imazhin.




Figura 30: Balancimi i imazhit me tekstin

5.1.3 Ngjyrat dhe nuancat e thjeshta

Meqenëse teknika e dizajnit kërkon elemente minimale, stili i dizajnit gjithashtu duhet ta plotësojë atë. Nëse përdorim gradient në këto dizajne, dizajni mund të duket shumë i punuar dhe i çrregullt. Prandaj mundohemi të përdorim ngjyra të thjeshta që kompletojnë njëra-tjetrën. Në përgjithësi, dizajnerët i përmbahen vetëm dy-tre ngjyrave. Përdorimi i dy ngjyrave ndihmon në krijimin e thellësisë dhe jep një efekt pop⁴. Ngjyrat shpesh ndihmojnë në krijimin e lidhjes emocionale, si dhe kompletojnë kuptimin e produktit për audiencën. Duke përdorur ngjyra neutrale theksojmë ndikimin e ngjyrës në modelin e përgjithshëm.



Figura 31: Set i ngjyrave dhe nuancave të tyre

5.1.4 Ekuilibrimi

Sigurohemi që tërësisht dizajni të jetë në ekuilibër. Përdorim elemente me vlera të ndryshme në dizajn duke përfshirë elemente më minimale. Meqenëse sa më pak elemente të përdorim, balancimi mund të arrihet më lehtë. Përdorimi i hapësirës negative bën që në një mënyrë dizajni të duket në përgjithësi i këndshëm.




Figura 32: Balancimi i dizajnit

⁴ Pop është një lëvizje e artit e shfaqur në mesin e shekullit të 20-të, në të cilën artistët përfshinin objekte të zakonshme komike, kanaçe, gazeta në punën e tyre.

5.2 Aplikimi i neo minimalizmit

Neo minimalizmi gjen aplikim në:

- Logo dhe dizajn
- Uebfaqe
- Dizajn të paketimeve
- Ikona






Figura 33: Dizajne të stilit neo minimalist

6. Trendet e së ardhmes

Industria e dizajnit grafik ndryshon dhe evoluon me kohën dhe trendet që mbizotërojnë në tregun konkurrues. Dizajnerët kanë filluar të përdorin mjete dhe teknologji inovative si VR⁵ dhe 3D, por gjithashtu kanë filluar të zhvendosin fokusin e tyre në stile dhe elemente vizuale të ndryshme që ndihmojnë në sjelljen në jetë të një identiteti unik të markës ose brendit. [18]

Pesë tendencat e dizajnit grafik që do pasojnë:

6.1.1 Minimalizmi po bëhet i zakonshëm

Linja të pastra, pamje të drejtpërdrejta por artistike që sjellin së bashku formën dhe funksionin bën që arti minimalist dhe ai neo minimalist të jenë metodat perfekte për t'u ofruar përvojë sa më të këndshme përdoruesve dhe për të krijuar dizajne të nivelit të lartë. Ndërsa ka tendenca të tjera që do të ndihmojnë në përgjigjen e pyetjes se cila është e ardhmja e dizajnit grafik, me siguri të plotë themi se minimalizmi është njëra prej tyre.



Figura 34: Fotografi minimaliste

⁵ VR apo realiteti virtual është përdorimi i teknologjisë kompjuterike për të krijuar një mjedis të stimuluar.

6.1.2 Ngritja e dizajnit 3D

Dizajni grafik 3D shërben si një kontrast me modelet mbizotëruese minimaliste që zënë çdo kanal marketingu dhe janë bloqet kryesore të ndërtimit të markave moderne. Dizajni i gjallë dhe abstrakt 3D synon të mbushë markat me identitetet e tyre unike vizuale, tani që të gjithë kanë filluar të ngjajnë me pamjet e tyre minimaliste.




Figura 35: Dizajni 3D

6.1.3 Zëvendësimi i blogjeve me përmbajtje vizuale

Vitet e fundit kemi qenë dëshmitarë të një zhvendosjeje të popullaritetit nga artikujt dhe postimet e thjeshta në blog drejt formave tërheqëse vizuale siç janë videot dhe imazhet, por kryesisht infografikat.



Figura 36: Infografikë

6.1.4 Përdorimi i tipografisë si shprehje artistike

Tipografia krijuese ka qenë gjithmonë një shprehje e fuqishme e dizajnit grafik. Në ditët e sotme, projektuesit janë duke u përqëndruar në krijimin e modeleve tipografike specifike për brendet në mënyrë që të plotësojnë veçantinë e pamjeve dhe personalitetit të tyre.




Figura 37: Poster i tipografisë

6.1.5 Dizajn që ju bën ta shikoni

Pamjet vizuale që ju bëjnë të ndaloni dhe ti vini re popullariteti i të cilave vazhdon e rritet, pasi që kompanitë janë të dëshpëruara për të gjetur një mënyrë për të dalë në pah në një det të markave uniforme dhe elementeve minimaliste. Ky trend i dizajnit nuk ka për qëllim të tërheqë të gjithë, përkundrazi, qëllimi i tij është të polarizojë tregun e konsumit dhe t'ju bëjë ta doni, ose ta urreni.



Figura 38: Dizajn që ju bën ta shikoni

7. Krijimi i dizajnit sipas parimeve të stilit minimalist

Dizajni i krijuar është punë origjinale dhe është zhvilluar në softuer profesional të dizajnit grafik.

7.1 Procesi i dizajnit

Së pari fillojmë me shqyrtimin e ideve rreth dizajnit, përzgjedhjen e fotografive apo ilustrimeve inspiruese dhe procesimit të ideve inspiruar nga fotografitë, ilustrimet apo tjetër.

7.1.1 Fotografitë inspiruese

Sipas dëshirës personale dhe inspirimit tema e dizajnit do të përmbajë elemente të lëshuara, të punuara me kujdes me detaje minimale dhe stil e shkrirje neutrale. Temë e dizajnit do të jenë lulet përkatësisht klasa e orhideve.



Figura 39: Fotografi inspiruese

7.1.2 Skicimi

Fillojmë me skicim në letër në mënyrë që ta kemi më të lehtë procesin e punimit në softuer, pasi që skicimi na bën të njohemi me linjat dhe konturat e dizajnit të cilin do ta zhvillojmë dhe e bën më të lehtë manipulimin me softuer të këtyre linjave.



Figura 40: Skicimi në letër

7.1.3 Punimi në softuer grafik

Fillimisht skica do të importohet në softuerin CorelDraw dhe më pas do të punohet sipas stilit të linjës me anë të mjeteve punuese të cilat na i ofron softueri. Më poshtë paraqitet skica e importuar e më pas e punuar me anë të editimit të linjave e bazuar në skicën e mëparshme.




Figura 41: Dritarja e softuerit CorelDraw me skicën e importuar




Figura 42: Linjat e punuara me veglat e softuerit CorelDraw të bazuar në skicë

7.1.4 Shtjellimi i ideve rreth dizajnimi të linjave skicore

Duke u mbështetur në stilin minimalist, vijojmë të dizajnojmë punimin deri kur të gjitha aspektet minimaliste të jenë përfshirë. Përdorim skicën si shembull dhe shtojmë detaje minimaliste edhe nëse konturat dhe linjat ndryshojnën thelbi i dizajnit mbetet i njejtë.



Figura 43: Theksimi i linjave

7.1.5 Thjeshtësimi dhe balancimi i dizajnit

Pasi kemi përfunduar skicimin parësor dhe kemi vendosur rreth pamjes së përgjithshme të dizajnit, vijojmë me hapin tjetër përkatësisht thjeshtësimin e dizajnit. Po ashtu krijojmë balancimin e dizajnit.




Figura 44: Thjeshtësimi dhe balancimi

7.1.6 Neutraliteti

Pas përfundimit të procesit të dizajnit dhe të thjeshtësimit të tij, vijojmë me zgjedhjen e paletës së ngjyrave e që në këtë rast, sigurisht që do jenë nuanca tejet neutrale. Duke u përshtatur temës dhe poashtu esencës së dizajnit.

Fontet e përdorura në dizajn: Brixton Outline

Nuancat e përdorura në dizajn: #fdf3eb në prapavijë, dhe #000000 në fonte dhe linja.

7.1.7 Finalizimi

Dizajni i paraqitur është dizajni final i tëri i punuar në softuer profesional të grafikës kompjuterike, ky dizajn u punua tërësisht duke pasur në mendje stilin minimalist, duke filluar që nga skicimi, ngjyra, forma, fontet e deri tek detajet më të imta. Ky dizajn mund të përdoret nga vet dyqanet e luleve pasi përfaqëson tërësisht lulen.




Figura 45: Dizajni final

8. Përfundimi

Qëllimi i këtij punimi është që të ofrojë një kuptim më të gjerë të rolit të minimalizmit në dizajnin modern të grafikës kompjuterike. Ky punim përshkruan ndikimin dhe mënyrën se si duhet ti qasemi fillimisht dizajnit dhe prezantimit të paradigmës së dizajnit minimalist. Përmes këtij shqyrtimi zhvilluam strategjitë se si mund të zbatohet dizajni grafik minimalist duke ndikuar drejtpërdrejtë në edukimin e brezave të ri të dizajnerëve grafik si dhe ofrimin e një praktike të re të dizajnit. Përmes këtij punimi kemi arritur të kuptojmë rëndësinë e dizajnit grafik si tërësi. Historikun e dizajnit grafik dhe metodave të tij. Metodave të dizajnit modern dhe atij minimalist. Kemi mësuar fazat e secilës nga këtyre metodave, ku secila fazë është shpjeguar dhe detajuar duke e bërë njohjen e këtyre trendeve të dizajnit lehtë të kuptueshme. Identifikuam dhe analizuam rastet konkrete për analizë të fazave të zhvillimit të një dizajni. U njohëm me trendet dhe metodat të cilat do pasojnë dhe implementuam të gjitha njohuritë duke u bazuar në teori në dizajn praktik. Në bazë të dizajnit të punuar, hap pas hapi kemi përfshirë të gjitha parimet e përmendura të dizajnit grafik modern e minimalist. Duke filluar me vet konceptin dhe inspirimin për dizajnin, përkatësisht fazën e parë. Me anë të fotografive inspiruese kemi bërë përzgjedhjen e ideve dhe inspirimit për dizajnin konkret. Pas fotografive inspiruese vazhduam me skicimin në letër të ideve rreth temës së punimit. Zgjedhëm softuerin grafik për të skicuar idetë me mjetet grafike. Eliminuar detajet e tepërta të dizajnit dhe thjeshtësuam e balancoam dizajnin. Më pas vazhduam të balancojmë dizajnin duke shtjelluar idetë rreth dizajnit të linjave skicore, në këtë mënyrë arritëm të thjeshtësojmë e balancojmë modelin. Duke u mbështetur në teorinë e ngjyrave zgjedhëm ngjyrat e dizajnit, duke përzgjedhur kështu ngjyra neutrale të përmendura në kapitullin e ngjyrave më lartë, vijuan poashtu me përzgjedhjen e fonteve adekuate për dizajnin. Fontet i zgjedhëm duke u mbështetur në kërkesat e fazës së neutralitetit. Vlerësuam dhe projektuam tërësisht fazat e minimalizmit që nga skicimi e deri te finalizimi i dizajnit dhe mund të themi se kemi realizuar dhe kuptuar në mënyrë të kompletuar dizajnin grafik modern e minimalist.

9. Literatura

- [1] A. Senefelder, Artist, *Rapid Transit*. [Art]. Boston Athenaeum, 1874.
- [2] P. B. Meggs, A history of graphic design, New York: Van Nostrand Reinhold, 1983.
- [3] H. d. Toulouse-Lautrec, Artist, *Jane Avril*. [Art]. Harris Brisbane Dick Fund, 1893.
- [4] K. Moser dhe J. Hoffmann, Artists, *Wiener Werkstatte*. [Art]. Austrian Paintings, 1903.
- [5] P. Rand, Artist, *IBM*. [Art]. Paul Rand Designs, 1981.
- [6] A. Warhol, Artist, *Marilyn Monroe*. [Art]. MoMa Art Gallery , 1967.
- [7] PetaPixel, Artist, *Adobe Photoshop*. [Art]. PetaPixel, 1990.
- [8] I. B. Designers, «InkBot,» InkBot, 22 March 2021. [Në linjë]. Available: <https://inkbotdesign.com/modern-graphic-design/>. [Qasja 23 August 2021].
- [9] P. Shaw, «Paul Shaw Design,» Paul Shaw, 23 May 2020. [Në linjë]. Available: www.paulshawletterdesign.com. [Qasja 6 August 2021].
- [10] S. J. Eskilson, *Graphic Design: A New History, Third Edition.*, New Haven: Yale University Press, 2019.
- [11] G. Novin, *A History of Graphic Design*, Ottawa: Oberon Press, 1994.
- [12] O. MOKHOV, «Spyre Studios,» Spyre Studios, 9 May 2011. [Në linjë]. Available: <https://spyrestudios.com/minimalist-design-a-brief-history-and-practical-tips/>. [Qasja 13 August 2021].
- [13] N. Y. F. Academy, «NYFA,» NYFA, 14 September 2016. [Në linjë]. Available: <https://www.nyfa.edu/student-resources/mastering-the-art-of-minimalist-graphic-design/>. [Qasja 4 August 2021].
- [14] Y. Iakovlev, «Zeka Graphics,» Zeka Graphics, 12 June 2020. [Në linjë]. Available: <https://www.zekagraphic.com/minimalist-graphic-design-rules/>. [Qasja 20 August 2021].
- [15] Schedio, «The Schedio,» The Schedio, 17 May 2020. [Në linjë]. Available: <https://theschedio.com/negative-space-logos/>. [Qasja 23 August 2021].

- [16] D. Marzona, *Minimal Art*, New York: Uta Grosenick, 2004.
- [17] R. Hooks, *Neo-minimalism in graphic design*, Chicago: New York Press, 2019.
- [18] T. Preechavutinant, «Future Trends on Minimalist Design,» *Issu Monthly*, vëll. i I, nr. 10, pp. 16-23, 2015.

Lista e figurave

Figura 1: “Rapid Transit” nga Muzeut i Bostonit Athanaeum	5
Figura 2: Jane Avril nga Henri de Toulouse-Lautrec	6
Figura 3: Historia e Dizajnit Grafik.....	7
Figura 4: Staatliches Bauhaus në Weimar 1919-1923.....	8
Figura 5: Logo nga Paul Rand për IBM	9
Figura 6: Marilyn Monroe (1967) nga Andy Warhol.....	10
Figura 7: Verzioni 1990 i Adobe Photoshop nga PetaPixel	11
Figura 8: Kompjueri Macintosh i prezantuar nga Steve Jobs.....	11
Figura 9: Shembull i dizajnit editorial dhe dizajnit ilustrativ	12
Figura 10: Paleta e ngjyrave neutrale	13
Figura 11: Modele të formave të shumëllojshme gjeometrike	14
Figura 12: Ikonat e sheshta.....	14
Figura 13: Disa lloje të fontit Serif.....	15
Figura 14: Sllajdet rrëshqitëse	15
Figura 15: Video e ngarkuar me tekst	16
Figura 16: “Pikturat e Zeza”(1967) nga Frank Stella.....	17
Figura 17: Thjeshtësia e dizajnit minimalist	18
Figura 18: Eliminimi i elementeve të panevojshme	19
Figura 19: Poster i punuar në stilin minimalist	19
Figura 20: Shembull i artit minimalist.....	20
Figura 21: Arti i linjës	21
Figura 22: Dizajni minimalist i një produkti	21
Figura 23: Logo e dizajnuar me anë të sistemit të rrjetave.....	22
Figura 24: Hierarkia vizuale	23
Figura 25: Dy shembuj të përdorimit të hapësirës negative	23
Figura 26: Uebfaqe të punuara në stilin minimalist	24
Figura 27: Logo e punuar në stilin modern minimalist	24
Figura 28: Shkrijra e artit tradicional në neo-minimalist	25
Figura 29: Fontet në stilin neo-minimalist	26
Figura 30: Balancimi i imazhit me tekstin.....	26
Figura 31: Set i ngjyrave dhe nuancave të tyre	27
Figura 32: Balancimi i dizajnit	27
Figura 33: Dizajne të stilit neo minimalist	28
Figura 34: Fotografi minimaliste.....	29
Figura 35: Dizajni 3D	30
Figura 36: Infografikë.....	30
Figura 37: Poster i tipografisë	31
Figura 38: Dizajn që ju bën ta shikoni.....	31
Figura 39: Fotografi inspiruese	32

Figura 40: Skicimi në letër	33
Figura 41: Dritarja e softuerit CorelDraw me skicën e importuar.....	34
Figura 42: Linjat e punuara me veglat e softuerit CorelDraw të bazuar në skicë	34
Figura 43: Theksimi i linjave	35
Figura 44: Thjeshtësimi dhe balancimi	35
Figura 45: Dizajni final	36

